



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KABINETI

**NJOFTIM PËR SHTYP**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë Biser Bidco S.a.r.l. dhe filialit të saj Nova Kreditna Banka Maribor d.d. nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 318 Prot., i AK, datë 30.06.2021 “Përqendrimi ndërmjet OTP Bank Nyrt. dhe Biser Bidco S,a.r.l., Nova KBM d.d.”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë Biser Bidco S.a.r.l. dhe filialit të saj Nova Kreditna Banka Maribor d.d. nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

Sipas “Marrëveshje e Shitblerjes së Aksioneve”, palët janë:

**Blerësi:** OTP Bank Nyrt. është një shoqëri publike aksionare që ushtron aktivitetin sipas ligjeve të Hungarisë dhe që ofron shërbimet e saj financiare universale nëpërmjet një sërë filialesh në Evropën Qendrore dhe Lindore.

Në Shqipëri, aktualisht OTP është prezente nëpërmjet filialit të saj *OTP Bank Albania SHA*, me objekt aktiviteti: pranimin e depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku, dhënie huash, ndërmjetësim i transaksioneve monetare etj.

**Shitësi:** Biser Topco S.a.r.l. është një shoqëri private, me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin sipas ligjeve të Dukatës së Madhe të Luksemburgut që operon si një shoqëri holding dhe nëpërmjet filialeve, ofron shërbime financiare.

**Shoqëria Target:** Biser Bidco S.a.r.l. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin sipas ligjeve të Luksemburgut, me objekt aktiviteti marrjen e pjesëmarrjeve në të gjitha shoqëritë ose ndërmarrjet në çfarë lloj forme dhe administrimi i këtyre pjesëmarrjeve, blerja me nënshkrim ose shkëmbim etj, i të gjithë titujve, aksioneve dhe vlerave të tjera të pjesëmarrjes nga çdo subjekt publik ose privat etj. Biser Bidco S.a.r.l. zotërohet 100% nga Biser Topco S.a.r.l.

Biser Bidco S.a.r.l. zotëron 100% i aksioneve të Nova Kreditna Banka Maribor d.d.

*Nova Kreditna Banka Maribor d.d.* është një bankë sllovene, me seli në qytetin Maribor. Aktiviteti kryesor konsiston në shërbimet bankare, shërbimet financiare dhe shërbimet financiare shtesë për të cilat ka marrë miratim nga Banka e Sllovenisë.

Nova Kreditna Banka Maribor d.d. nuk ka filiale në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**